



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI TIRANË
FAKULTETI I GJUHEVE TE HUAJA
ADMINISTRATORI

N J O F T I M

PËR MARRJEN ME QIRA TË NJË APARTAMENTI

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Universitetit të Tiranës dhe Ministrisë së Shkencave, Arsimit dhe Rinisë të Republikës së Kroacisë” Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës është i interesuar për marrjen me qira të një apartamenti në qytetin e Tiranës për akomodimin e një personi.

Kriteret që kërkohet të plotësohen nga ofertuesit janë si më poshtë:

- Apartamenti të ndodhet në qytetin e Tiranës afër me Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, me vendndodhje në Rugën e Elbasanit.
- Apartamenti të jetë 1 + 1 dhe i kompletuar me të gjithë komoditetet e nevojshme për banim e kryerjen e nevojave të tjera jetike.
- Ofertuesi të disponojë dokumentacion të rregullt pronësie për apartamentin.
- Afati i qirasë të jetë 9 (nëntë) muaj, me të drejtë shtyerje.
- Pagesa do të bëhet një herë në muaj në llogarinë e qiradhënësit.
- Fondi në dispozicion 600,000 lekë
- Oferta dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet brenda 3 (tre) ditëve nga publikimi i njoftimit në Protokollin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Nr. Kontakti për çdo sqarim: 067 66 49 999

Tiranë, më 16.09.2026

ADMINISTRATORI I FAKULTETIT

Ramadan ÇAÇO